



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



Periudha për regjistrimin e votuesve jashtë Kosovës (29 mars – 3 prill 2024) për votimin e 21 prillit në katër komunitat Leposaviq, Zubin Potok, Zvečan dhe Mitrovicë e Veriut

Prishtinë, 29 mars 2024 – Komisioni Qendror i Zgjedhjeve njofton qytetarët me të drejtë vote se ka filluar periudha për aplikim për t'u regjistruar si votues jashtë Kosovës për procesin e votimit për apo kundër largimit të kryetarëve nga funksioni i tyre në komunitat Leposaviq, Zubin Potok, Zvečan dhe Mitrovicë e Veriut, që do të mbahet më 21 prill 2024.

Gjatë kësaj periudhe, e cila do të përfundojë më 3 prill 2024, shtetasit e Kosovës që jetojnë jashtë vendit, mund të aplikojnë për t'u regjistruar si votues jashtë Kosovës duke dërguar kërkesën e tyre përmes:

1. **Platformës elektronike** e cila është e vendosur në ueb faqen e KQZ-së www.kqz-ks.org: **Regjistrohu për votim jashtë Kosovës për procesin e votimit më 21 prill 2024** (<https://eomp.kqz-ks.org/sq/abroadvoter>), duke ndjekur të gjithë hapat njëri pas tjetrit, ose
2. **Postës.**

Të gjitha detajet për periudhën e aplikimit për regjistrim si votues jashtë Kosovës janë publikuar në ueb faqen e KQZ-së www.kqz-ks.org (Shërbimet e KQZ-së > Shërbimet për votuesit > Votimi përmes postës) apo në vegzën: <https://kqz-ks.org/sherbimet-per-votuesit/votimi-me-poste/>

Në rast të refuzimit të aplikimit për t'u regjistruar si votues jashtë Kosovës, KQZ ka themeluar Komisionin për Kundërshtimin Administrativ, ku mund të parashtrahet kundërshtimi kundër njoftimit të KQZ-së. Kundërshtimi administrativ mund të dërgohet përmes e-mailit, në: kundershtimi.vjk@kqz-ks.org

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve inkurajon të gjithë shtetasit e Kosovës me të drejtë vote që jetojnë jashtë Kosovës – që të shfrytëzojnë të drejtën e tyre për t'u regjistruar si votues jashtë Kosovës dhe pastaj, pas regjistrimit, të votojnë përmes postës gjatë periudhës e cila fillon më 12 prill dhe përfundon më 20 prill 2024.